

KËRKESË
Nr. 1191, datë 10.11.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“EDIL-CENTRE”

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, megjithëse kanë realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, institucioni ynë bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. EDIL-CENTRE (NIPT: J61811017V)

DREJTOR
Xhevdet Haxhiaj

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. AKM-TR-2020-000011-5

Datë 9.9.2020

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. AKM-TR-2020-000011-2, datë 8.9.2020, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “EDIL-CENTRE”, me NIPT J61811017V, punëdhënës, prej datës 8.9.2020, ora 08:00, deri më datë 8.9.2020, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 8.9.2020 dhe e njoftoi në datën 8.9.2020.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 54.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 100 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Andi Kuci ID ____

Jetnor Zhelegu ID ____

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “EDIL-CENTRE” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.